

VENDIM
Nr. 183, datë 25.3.2021

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE “BLUE
2”, I CILI NUK PËRFITON NGA MASAT MBËSHTETËSE, NË ZONËN SHEQ-
MARINAS, BASHKIA FIER, QARKU FIER, NGA BASHKIMI I PËRKOHSHËM I
SHOQËRIVE “BLESSED INVESTMENT” SHPK DHE “MATRIX
KONSTRUKSION” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse “Blue 2”, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k., me elementet si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k.;

b) Numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS:

“Blessed Investment” sh.p.k. - L71423028S

“Matrix Konstruksion” sh.p.k. – J91306009Q.

c) Tipi centralit: fotovoltaik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 50 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë: koha për ndërtimin e vënien në operim të parkut fotovoltaik do të jetë brenda 50 (pesëdhjetë) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: centrali fotovoltaik “Blue 2”, zona Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier;

e) Afati i miratimit të ndërtimit: 60 (gjashtëdhjetë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij miratimi;

ë) Koordinatat e tokës sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucione të tjera të autorizuar prej saj kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore, gjatë realizimit të vënies në punë, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit të dokumentacionit të projektit;

g) Transferimi i së drejtës për ndërtim të burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një person i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

gj) Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ose institucioneve të tjera të autorizuar prej saj informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat e autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë

përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penaltitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj. Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k. do të krijojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit një shoqëri për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaiik “Blue 2”. Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k., dhe shoqëria, për qëllime të veçanta, do të jenë bashkërisht përgjegjës për detyrimet, sipas këtij miratimi dhe kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë, sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k. duhet t’i derdhë tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKSI 1

Sipërfaqja e tokës: 1,418,688 m², rreth 141 ha.

Koordinatat e tokës

X_UTM	Y_UTM	X_GAUSS	Y_GAUSS	X_KRRGJSH	Y_KRRGJSH
367465.9786	4519597.756	4367543.3805	4521537.123	451783.5075	4520375.163
367470.9233	4519373.602	4367548.3271	4521312.878	451791.0111	4520151.032
367424.8799	4519119.123	4367502.2648	4521058.295	451747.8651	4519895.991
367274.5066	4518945.03	4367351.83	4520884.131	451899.4564	4519720.156
367095.8404	4518400.005	4367173.0906	4520338.884	451426.9832	4519173.012
366453.5628	4517603.751	4366530.5506	4519542.306	450793.6968	4518369.314
366792.3962	4518741.859	4366869.5229	4520680.877	451119.5938	4519511.454
367239.4816	4519289.95	4367316.7909	4521229.191	451560.49	4520064.726
367287.2512	4519250.773	4367364.58	4521189.999	451608.7137	4520026.09
367421.4783	4519414.948	4367498.862	4521354.241	451741.087	4520191.82
367194.791	4519605.466	4367272.0823	4521544.837	451512.192	4520379.779
367132.0614	4519528.26	4367209.3271	4521467.6	451450.3344	4520301.846
366928.2331	4519694.698	4367005.4157	4521634.105	451244.5767	4520465.982
367280.5232	4520773.318	4367357.8501	4522713.165	451584.6068	4521548.781
367380.2997	4521354.315	4367457.6677	4523294.399	451677.7654	4522131.003
367927.9578	4521031.708	4368005.549	4522971.66	452229.1873	4521814.6
367899.7435	4520580.111	4367977.3229	4522519.879	452206.124	4521362.614

Shtrirja gjeografike e vendit ku do të zhvillohet impianti fotovoltaik “Blue 2”:

